



Korrik 2013

Zëri i Grave Kosovare

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Bashkangjitu!

Takimi i Rregullt i RrGGK

2 Shtator, 10-16, Hotel Prishtina

Të gjeturat fillestare: "Ku janë Paratë për të Drejtat e Grave?"

2 Shtator, 14-16, Hotel Prishtina

Retreat i RrGGK (vetëm Anëtarët)

3-6 Tetor, Durrës

Në këtë Numër

Fondacioni IPKO Dhuron €5000 dhe Bëhet Partner i RrGGK.....2

RrGGK iu bën Thirrje të Gjitha Vajzave Aktiviste, Feministe2

Historitë e Grave dhe Burrave Pasurojnë Historinë e Kosovës3

Komuna përkrahë OJQ Gruaja Hyjnore në Fuqizimin e Grave3

1100 Udhëheqës Diskutojnë Fuqizimin e Grave4

12.764 Qytetarë Nënshkruajnë Peticionin e Shoqërisë Civile kundër Ligjit të Kosovës për Amnisti4



**Faqja në Facebook
Grupi në Facebook**



**Lista e dërgesave
të E-Lajmeve**

4) **Rikotta** do të përurojë "Tregun e Grave" në sheshin Nëna Terezë në Prishtinë, ku do të shiten produkte të grave dhe do të organizohen aktivitete në rrugë për të ngritur vetëdijësimin për të drejtat e grave; 5) **Foleja** do të edukojë gratë dhe vajzat e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian në Prizren, Landovicë, Piranë, Serbicë Jugore dhe Mamushë për shëndetin dhe të drejtat e tyre; 6) **Rona** do të fuqizojë ekonomikisht gratë, duke përkrahur pjesëmarrjen e tyre në turizëm përmes punimeve të dorës dhe duke promovuar trashëgiminë kulturore në Gorë dhe Opojë; dhe 7) **Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave** do të identifikojë rastet e dhunës seksuale të kryera gjatë luftës në 17 fshatra të Komunës së Drenasit. Kvinna till Kvinna ofroi përkrahjen financiare për të bërë të mundur ndarjen e këtyre granteve. Raundi i radhës i granteve do të hapet më 15 Gusht dhe do të mbyllet më 15 Shtator 2013. **Mimoza Paçuku**, koordinatore e FGK, është e gatshme për të ofruar mentorim për anëtarët e RrGGK-së lidhur me projekt propozimet e tyre.

RrGGK Mirëpret Anëtarët Individual!

A jeni adhures, mik ose përkrahës i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK)? Ndoshta ju nuk keni organizatë tuajën ose nuk jetoni në Kosovë, por ndiheni i/e lidhur me punën tonë dhe dëshironi të na përkrahni? Ne kemi një program të ri për ju! RrGGK ka kënaqësinë të shpallë Programin tonë të ri për Anëtarësim Individual. Programi iu ofron individëve mundësinë për tu bërë pjesë e rrjetit tonë!

Për tu bërë anëtar i RrGGK, ne mirësisht kërkojmë një donacion prej €50 në vit (që është më pak se €5 në muaj). Natyrisht që ne çmojmë çdo donacion shtesë që ju shprehni dëshirën ta bëni! Për banorët në SHBA donacionet lirohen nga taksat. Të gjitha të ardhurat do të shkojnë në Fondin e Qëndrueshmërisë të RrGGK, duke mbuluar kështu shpenzime qenësore dhe duke përkrahur programe të rëndësishme. Si anëtar, ju do të pranoni informata të përditësuara për punën e RrGGK-së dhe atë se si i kemi shpenzuar fondet e anëtarëve për qëllime të mira. Kjo përfshinë E-Buletinin mujor dhe raportin vjetor me pasqyrat financiare të audituara. Ne poashtu do të përfshijmë emrin tuaj në listën tonë të anëtarëve (përveç nëse ju preferoni që të mos e bëjmë këtë gjë).

Si një anëtar i RrGGK-së, ju mund të ndiheni krenarë që jeni pjesë e një rrjeti mbarë botërorë të njerëzve të përkushtuar për të mbështetur, mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë. Për tu anëtarësuar, ju lutem shkruani në info@womensnetwork.org apo vizitoni uebfaqen tonë. P.S. Për tu anëtarësuar nuk është e nevojshme të jeni grua. Ne mirëpresim edhe burrat që përkrahin punën tonë!



Më 30 Korrik, RrGGK mirëpriti anëtarin e parë individuale Elizabeth Kaestli, përkrahëse për një kohë të gjatë e shtytjes përpara të të drejtave të grave në Kosovë.

RrGGK Përkrahë Iniciativat e 7 Anëtareve

RrGGK gjatë muajit Korrik aprovoi shtatë grante të **Fondit të Grave të Kosovës** (FGK) për organizatat anëtare. Në këtë raund aplikuan 29 organizata dhe Komisioni Përzgjedhës për Grante (KPG) i FGK-së, i përzgjedhur nga anëtarët e RrGGK përzgjedhi si vijon: 1) **Venera** do t'i ndihmojë gratë në Pejë që të përgatisin dokumentet ligjore dhe t'iu ofrojë këshillime për kompletimin e procedurave për të hapur bizneset e tyre; 2) **Blini** do të ngrisë vetëdijësimin për shëndetin riproduktiv në mesin e vajzave në Drenas; 3) **Komiteti i Grave të Verbëra të Kosovës** do të punojë në integrimin e fëmijëve të verbër në shkollat publike në Prishtinë;

Fondacioni IPKO Dhuron €5000 dhe Bëhet Partner i RrGGK

Fondacioni IPKO (FI) ka dhuruar €5000 për programet dhe iniciativat e RrGGK-së. Të dy organizatat, më 23 Korrik nënshkruan një memorandum.

“FI mendoi se dhurimi i të hollave për Fondin e Grave të Kosovës të RrGGK-së do të ishte një mundësi shumë e mirë për filantropi,” tha Teresa Crawford, Anëtare e Bordit Themelues të FI. “Pasi kjo shumë i është dhuruar RrGGK-së për qëllime të përgjithshme, RrGGK mund ta përdorë atë edhe për projekte e aktivitete të tjera.”

RrGGK planifikon t'i përdorë fondet për avokim dhe promovim të drejtave të grave. FI dhe RrGGK poashtu diskutuan fusha të ndryshme potenciale për bashkëpunim të mëtutjeshëm, duke përfshirë edhe përkrahje të mundshme në të ardhmen nga FI për Fondacionin për Arsimimin e Vajzave “Çifti Buçinca”, përmes programit të tij [Bursa për Gjeneratat e Ardhshme](#).

“RrGGK poashtu po punon në fuqizimin e vajzave përmes Iniciativës për Fuqizimin e Vajzave,” tha Igballe Rogova, Drejtoreshë Ekzekutive e RrGGK-së. “Me qëllim të fuqizimit të vajzave, ne duhet të gjejmë mënyra për të përkrahur arsimimin e tyre. Më shumë rrjetëzim mund të kontribuojë në këtë.”

FI poashtu ofroi që të angazhojë bursistët e vet për t'i ndihmuar anëtarët e RrGGK-së, për shembull në ofrimin e punësive për teknologji. “Disa nga bursistët tanë do të mund të mbanin sesione informative për teknologjinë dhe përdorimin e mediave sociale për promovimin e punës dhe aktiviteteve,” tha Abetare Gojani, Menaxhere e Programit të FI.

“Mediat sociale mund të mbështesin avokimin e anëtareve të RrGGK-së,” u pajtua me parafolësen Rogova.

FI dhe RrGGK planifikuan aktivitete të përbashkëta shtesë për të promovuar punën e tyre dhe për të gjetur përkrahje financiare shtesë për RrGGK-në. Pasi që FI është anëtar i [Odës Ekonomike Amerikane \(OEA\)](#) në Kosovë, kjo organizatë do të shohë mundësinë e organizimit të një ngjarjeje me anëtarët e tjerë të OEA-së, për t'i njoftuar ata me RrGGK-në, si përkrahës të mundshëm të ardhshëm.



Fondacioni IPKO (FI) dhe RrGGK nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi më 23 Korrik.

RrGGK iu Bën Thirrje të Gjitha Vajzave Aktiviste, Feministe

Vajza a dëshironi të përfshihen në lëvizjen e grave? Apo vetëm të kërkonit të drejtat tuaja? Nëse po, atëherë RrGGK iu fton t'i bashkangjiteni [Iniciativës për Fuqizimin e Vajzave \(IFV\)](#).

Të shqetësuar nga konflikti në mes të gjeneratave dhe duke kërkuar të krijojmë një lëvizje më të fortë të grave në Kosovë, ne në vitin 2012 inicim IFV me mbështetje nga Kvinna till Kvinna. Përmes saj, ne duam të ndihmojmë më shumë vajza që të marrin pjesë në politikë, vendim-marrje dhe organizim për të kërkuar të drejtat e tyre.

Javën e kaluar, vajzat aktiviste dhe udhëheqëse nga disa organizata, si dhe aktiviste dhe grupe të artisteve u mbledhën në Prishtinë për të krijuar strategji për të ardhmen e IFV. Ato diskutuan për të përfshirë sa më shumë vajza duke shfrytëzuar kapacitetet e tyre ekzistuese, si dhe për të organizuar ngjarje sociale që mund të mbledhin njerëz. Ndoshta ju keni ndonjë ide lidhur me këtë, të cilën dëshironi ta ndani me ne? Bashkangjiteni diskutimit në [grupin](#) tonë në Facebook!

Ja disa informata lidhur me veprimet e ndërmarra deri më tani: 87 vajza janë mbledhur në pesë regjione të Kosovës (Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Gjilan dhe Mitrovicë) për të diskutuar shqetësimet dhe për të ndarë strategji. Siç duket vajzat përballen me të njëjtat probleme: diskriminimin në baza gjinore, seksizmin, ekstremizmin fetarë, çasjen e pamjaftueshme në arsimim dhe papunësinë. Aktivitetet e IFV poashtu përmendën çështjet lidhur me udhëheqësit e OJQ-ve dhe politikanët (disa nuk e konsiderojnë të mjaftueshme përvojën e vajzave për caktimin e tyre në pozita vendim-marrëse). A po përballeni ju me ndonjë çështje shtesë? [Check-in](#) dhe na tregoni lidhur me atë përvojë!

Eh pra, çka më tutje? Ne nuk duam vetëm të flasim për probleme. Ne duam t'i zgjidhim ato! Kështu që, aktivistet e IFV kanë shkëmbyer ide. Na u bashkangjitni këtë vjeshtë kur ne do të bëjmë identifikimin e strategjive avokuese dhe vihuni në veprim! Ne do të vijmë në qytetet afër jush për tu organizuar sër bashku. Na njoftoni nëse jeni të interesuar. Na shkruani në info@womensnetwork.org dhe ose bashkangjiteni në [grupin](#) tonë në Facebook për tu siguruar që jeni të informuar për ngjarjet e ardhshme. Bëhuni pjesë e lëvizjes!



Vajzat prezantojnë problemet e nevojat e tyre, si dhe strategjitë për adresimin e tyre në njërin nga takimet e IFV në Gjakovë.

Historitë e Grave dhe Burrave Pasurojnë Historinë e Kosovës

Iniciativa e Historisë Gojore mundohet të zgjerojë kuptimin/-et e ngushtë/-a të historisë duke ofruar detaje për jetën e përditshme të Kosovarëve para, gjatë dhe pas luftës. Iniciativa ka regjistruar storie të çdo gjëje që nga hamamet Turke tek fantazmat e fëmijërisë tek dervishët tek rezistenca paqësore tek shtypja gjatë viteve të '90. Të tilla kujtime, të ruajtura në film, të transkriptuara e përkthyer, luajnë një rol kyç në ruajtjen e historisë së Kosovës të ditëve moderne.

Iniciativa e Historisë Gojore është një bashkëpunim i përbashkët në mes të RrGGK dhe New School në New York. Që kur u themelua në vitin 2012, Iniciativa ka dokumentuar jetën personale të 11 figurave kurajoze, përfshirë Naxhije Buçinca, Vjosa Dobruna, Marte Prekpalaj, Drita Vukshinaj, Safete Rogova, Shqipe Malushi, Sevdije Ahmeti, Nazlije Bala, Vehap Shita, Pajazit Nushi dhe Antonella Giorgioni. Këtë vjeshtë, historitë e tyre dhe të të tjerëve do të publikohen në një uebfaqe me mundësi kërkimi, interaktive dhe multi-mediale. Uebfaqja do të përmbajë inçizimet e papërpunuara të intervistave të tyre, transkriptat në gjuhën shqipe dhe angleze, fotografi historike dhe eventualisht filma të shkurtër.

Iniciativa udhëhiqet nga një Grup i Historisë Gojore që përfshin RrGGK, Dr. Anna di Lellio dhe studentët e saj nga New School dhe një numër hulumtuesish, akademikësh, krijuesish të filmave dhe praktikantëve të pavarur. Ne do të donim të falenderonim Catherine McGahan, Jung Chao, Kaltrina Krasniqi, Eda Shehu, Donjeta Berisha, Emine Berisha dhe Erla Gjinishi për punën e tyre vullnetare këtë verë, për krijimin e arkivit të Historisë Gojore.

Nëse dëshironi të përkrahni këtë iniciativë unike, mund të dhuroni donacion përmes sponsorit tonë fiskal, East-West Management Institute në New York, ku individët të cilët jetojnë në SHBA tani mund të dhurojnë donacione që lirohen nga taksat përmes çekut (info [këtu](#)) ose kredit kartelë (vetëm përshkruani në vijën për shënim që donacioni është "për Iniciativën e Historisë Gojore të RrGGK"). Një përkrahës zemërgjërë anonim është pajtuar që të përshtatë dollarë-për-dollarë çdo donacion që dhurohet për këtë iniciativë. Prandaj, donacioni juaj do të vlejë dyfish!

Nuk keni para të gatshme të mjaftueshme por dëshironi të ndihmoni? Ne ende po kërkojmë krijues filmash, regjisor, intervistues (në gjuhën shqipe) dhe përkthyes që duan të ofrojnë punë vullnetare me gjysëm orari ose me orar të plotë. Nëse jeni të interesuar të përfshiheni vullnetarisht në Iniciativën e Historisë Gojore, ju lutemi na shkruani në: info@womensnetwork.org.



Njëri prej rrëfimeve të historisë gojore dokumenton jetën e aktivistes të të drejtave të njeriut dhe pediatres Vjosa Dobruna. Diplomimi i saj në Pediatri në Zagreb të Kroacisë, në vitin 1981, e bën storian e saj një storie të suksesit dhe lëvizjes në ish-Jugosllavi, të përcjellë nga aktivizmi dhe rezistenca ndaj pushtetit të qeverisë serbe gjatë viteve të '90.

Komuna Përkrahë OJQ Gruaja Hyjnore në Fuqizimin e Grave

Komuna e Gjilanit i ka ofruar OJQ-së *Gruaja Hyjnore* hapësirën për përdorim pa pagesë për aktivitetet e tyre. Bashkëpunimi me Komunën i ka mundësuar organizatës zvogëlimin e shpenzimeve, duke kontribuar në mënyrë substanciale në qëndrueshmërinë e saj.

"Komuna e Gjilanit po mundohet t'i kushtojë shumë vëmendje të drejtave dhe interesave të grave, pasi që e dimë se roli i grave në shoqëri është i pazvëndësueshëm," tha Omer Daku, zëvendës Kryetar i Komunës së Gjilanit. "Ne, si komunë, po mundohemi të krijojmë më shumë hapësirë për gratë që të veprojnë dhe të ndër marrin më shumë aktivitete."

Gruaja Hyjnore ka përdorur hapësirat e reja të punës për të fuqizuar ekonomikisht gratë. Me përkrahje nga Fondi i Grave të Kosovës, ato kanë mbajtur punëtori për barazinë gjinore, të drejtat e grave në trashëgiminë e pronës dhe teknika të avancuara të punimeve punëdore. "Aktivitetet e OJQ-së më kanë ndihmuar mua, si grua pa arsimim të lartë, që të dalë nga rutina ditore; të takojë gra të tjera;

të shkëmbejë përvoja; të marrë pjesë në trajnime për teknika të reja për punime punëdore; të pranojë certifikata; të shfaqë punën time në ekspozitë të ndryshme; dhe mbi të gjitha të ndihem më e vlefshme," tha Alije Ajeti, një pjesëmarrëse. "Një tjetër gjë shumë e rëndësishme është se kam mundur t'i shesë punimet e mia të punëdore dhe në këtë mënyrë unë kam mbështetur ekonomikisht familjen time."



Anëtare dhe përkrahëse të OJQ Gruaja Hyjnore në Gjilan, të mbledhura në hapjen zyrtare të zyrës së tyre që iu ofrua për përdorim pa pagesë nga Komuna e Gjilanit.

1100 Udhëheqës Diskutojnë Fuqizimin Ekonomik të Grave

Një delegacion i udhëhequr nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga përfaqësoi Kosovën në [Samitin Global të Gruas 2013](#). Delegacioni poashtu përfshinte përfaqësuesen e RrGGK-së Mirlinda Kusari-Purrini, Drejtoreshë Ekzekutive e [SHE-ERA](#) dhe Afërdita Saraçini Kelemendi, Presidente e Odës Ekonomike të Grave të Kosovës. Samiti, i mbajtur në Kuala Lumpur, Malajzi me 6-8 Qershor, mbledhi rreth 1100 udhëheqës botërorë nga rreth 70 vende për të diskutuar temën: Krijimi i Ekonomive të Reja. Ngjarja shërbeu për krijimin e lidhjeve në mes të sektorit publik, privat dhe jo fitimprurës.

“Ne kishim mundësinë të takohemi dhe të ndajmë përvoja me gra udhëheqëse nga qeveritë dhe bizneset,” tha Zn. Kusari-Purrini. “Ne poashtu mësuam për statusin global të gruas.”

Samiti synonte të promovonte dhe informonte gratë sipërmarrëse përmes një forumi vjetor, hulumtimit, tryezave të rrumbullakëta dhe programeve të tjera.



1100 udhëheqës botërorë nga rreth 70 vende diskutojnë “Krijimin e Ekonomive të Reja” në [Samitin Global të Gruas 2013](#), me 6-8 Qershor në Kuala Lumpur, Malajzi.

12,764 Qytetarë, Peticioni i Shoqërisë Civile kundër Ligjit të Kosovës për Amnisti

Projekt Ligji për Amnistinë në Kosovë doli nga marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai kishte për qëllim të mbështesë integrimin e serbëve në veriun e Kosovës duke iu ofruar mbrojtje nga aktet ligjore që rrjedhin pas rezistencës së serbëve ndaj Kushtetutës së Kosovës që nga deklarimi i pavarësisë në vitin 2008. Megjithatë, [projektligji fillestar](#), sipas disa parlamentarëve, “tejkalon marrëveshjen për amnisti dhe provon të ofrojë amnisti për krimet ordinere që janë kryer në territorin e Kosovës.” Pa marrë parasysh shqetësimet, parlamenti përdori procedura të përsheptuara pa ndonjë diskutim publik, kur mbajti leximin e parë të projektligjit më 4 Korrik.

RrGGK [reagoi](#) kundër Projektligjit për Amnistinë dhe iu kërkoi parlamentarëve që të mos votojnë për të pasi që do të ofronte amnisti për një numër të akteve kriminale, përfshirë edhe dhunën kundër gruas. Qytetarë të ndryshëm poashtu protestuan pranë parlamentit dhe turma u shpërmda vetëm atëherë kur projektligji nuk kaloi. Në leximin e tij të parë, projektligji morri vetëm 70 vota në favor, që nuk ishin të mjaftueshme për 80 votat e nevojshme.

Shqetësimet mbi polemikat rreth Nenit 3 bën që Qeveria të shtojë një pikë që theksonte se veprat që rezultojnë nga vrasjet apo lëndimet trypore nuk do të amnistohen.

Kur leximi i dytë i projektligjit u paralajmërua për datën 11 Korrik, qytetarët e Kosovës organizuan një tjetër protestë pranë Parlamentit. Ajo zgjati gjashtë ditë e pesë netë. Protestuesit e bënë të qartë që ata nuk përfaqësojnë ndonjë institucion apo parti politike. Më tutje, pas një numri të reagimeve individuale, 34 organizata të shoqërisë civile (OSHC) i shkruan një [letër të përbashkët](#) Zyrës së BE-së në Kosovë, EULEX-it dhe Ambasadave të shteteve të Quint-it duke kërkuar që Projektligji për Amnistinë të rishikohet. Ato poashtu inicuan një peticion të qytetarëve, duke kërkuar amendamentimin e ligjit. Qytetarët protestuan prapë jashtë parlamentit në të njëjten kohë kur në parlament po mbahej leximi i dytë i ligjit.

Pa marrë parasysh protestën e qytetarëve, më 11 Korrik Ligji për Amnistinë kaloi me 91 vota në favor dhe 17 kundër.

Qytetarët vazhduan të protestonin gjatë datës 19 Korrik duke nënshkruar peticionin e lartpërmendur. Në total, OSHC-ja mbledhi 12,764 nënshkrime. Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave, Grupi për Studime Politike dhe

Juridike, RrGGK, Community Building Mitrovica, *Syri i Vizionit*, *EC Ma Ndryshe* dhe INPO dorëzuan peticionin në Presidencë, duke kërkuar që projektligji të kthehet në Kuvend ([shikoni letërën e tyre](#)).

Presidentja Jahjaga vlerësoi angazhimin dhe rolin e shoqërisë civile në demokratizimin e Kosovës. “Komunikimi në mes të institucioneve dhe shoqërisë civile është i nevojshëm dhe kontribuon në përmirësimin e përgjithshëm të proceseve,” tha ajo.

Pasi që Ligji do të mund të mbahet nga Gjykata Kushtetuese, RrGGK do të vazhdojë të avokojë për rishikime.



Përfaqësuesit e OSHC dorëzojnë peticionin që kërkon amendamentimin e Ligjit për Amnisti tek Presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga me 19 Korrik.